

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Konferenca - Berisha: Denoncoj me forcën më të madhe kërcënimet ndaj gruas dhe familjarëve të Ahme tajt me urdhër të Ramës
ADRESA	https://www.syri.net/politike/916545/berisha-denoncoj-me-forcen-me-te-madhe-kercenimet-n-daj-bashkeshortes-dhe-familjareve-te-arben-ahmetajt-me-urdher-te-edirames/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 11:31:23 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 11:24:06 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ac3ee816cb39b9afdc82cac2e120bab3dff22c802452dbe7e5bf773fb4e15912
TEKSTI	b9852b1bf25b9ec7b01e4acf41b018a0e8d8bacbe948024d8b416ca30f130541
PAMJA	80409e7bdd1b1681945efddf8f41943e1ff7afa5f6948ae29a7e95621425e63f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f08173389ae130d856b5429103b96f61b91844176603194afae76713f8c3b8ae
E MËPARSHMJA	7d63e3a1dcf8ec7a6a2193d50b5d222a169c18e3e52c00906ab378eb70da3ddb
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f08173389ae130d856b5429103b96f61b91844176603194afae76713f8c3b8ae>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



IRENA BEQIRAJ

Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!



AGIM XHAFKA

Dialog me mbesën

LAJMI I FUNDIT

A do mbushet bregdeti i Semanit me parqe foto voltaike? Sadushi i Fierit hap 5 tendera për dhënie me qira të 391 mijë m2 tokë

më të lexuarat


Modeli Kayo, Bozdo: Janë krijuar 20 kompani, kanë marrë monopolin në disa fusha

Zhupa: Nga shkollat me turne te emigrimi i të rinjve, problemet mbeten të njëjta, fëmijët paguajnë çmimin

'Mafia emëron ministrat në qeverinë Rama', Kepi: E kanë të lehtë të gjejnë personin e duhur për aferat e tyre

Berisha në Konventën Republikane në Dallas - Takime me drejtues të Departamentit të Drejtisë, Takime me senatore

Shqiptari nga Anglia: Rama dhe urdhër të mos hyjmë në shesh! Të rimë këtu derisa ta shporrim nga zyra antishqiptarin



Berisha: Denoncoj me forcën më të madhe kërcënimet ndaj gruas dhe familjarëve të Ahmetajt me urdhër të Ramës

13:24, 14/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Gjatë konferencës për median një javë pas vizitës në SHBA, lideri i PD-së, Sali Berisha u pyet edhe lidhur me audiopërgjimin që Arben Ahmetaj denoncoi në intervistën për emisionin 'Çim Peka Live' në Syri Televizion. Bëhet fjalë për skandalin që ka të bëjë me trafikun ndërkombëtar të armëve dhe dyshimet për lidhje me qeverinë.

Berisha tha se kemi të bëjmë me një denoncim të një rëndësie të jashtëzakonshme, në të cilin provohet se një vend anëtar i NATO-s, në kundërshtim flagrant me ligjin shqiptar dhe ndërkombëtar, merret me punë të pista armësh. Ai gjithashtu dënoi me forcën më të madhe kërcënimet ndaj bashkëshortes dhe familjarëve të Arben Ahmetajt me urdhër të Edi Ramës

Pjesë nga konferenca

Marsi Korreshi: Zoti Berisha, ndërkohë që ju ishit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ish-numri dy i qeverisë, Arben Ahmetaj, do të denonconte në një intervistë për emisionin 'Çim Peka Live' në Syri Televizion, një tjetër skandal që ka të bëjë me trafikun ndërkombëtar të armëve dhe dyshimet për lidhje me qeverinë. Keni një koment për këtë skandal dhe çfarë do të bëjë opozita pas publikimit të audio-përgjimit?

Sali Berisha: Ai ishte një denoncim i një rëndësie të jashtëzakonshme, në të cilin provohet se një vend anëtar i NATO-s, në kundërshtim flagrant me ligjin shqiptar dhe ndërkombëtar, merret me punë të pista armësh.

Por u them shqiptarëve, se në qoftë se ka binjakë të pandarë, janë droga dhe armët, armët dhe droga. Ai që bën drogën bën dhe armët, ai që bën armët bën dhe drogën.

Në këtë kuadër, mendoj se denoncimi i Arben Ahmetajt, të cilin unë e përgëzoj për këtë denoncim jashtëzakonisht të çmuar, plotëson kuadrin e vërtetë të këtij

regjimi.

Sikundër denoncoj me forcën më të madhe kërcënimet që u janë bërë bashkëshortes dhe familjarëve të Arben Ahmetajt, me urdhër padyshim të Edi Ramës dhe strukturave të narkoshtetit.

Sepse pas këtij denoncimi, kanë vërshuar kërcënimet drejt familjes së tij.

Natyrisht, opozita do të bëjë të gjitha përpjekjet e veta, por Roni Yeffet, që është varianti joshqiptar i Gys Agasit, përbën dhe ai një element tjetër në zinxhirin e akteve mafioze të Edi Ramës.

Dhe sot, janë dorëzuar firmat për krijimin e komisionit hetimor parlamentar mbi veprimtarinë antikushtetuese, antiligjore, korruptive të Edi Ramës dhe kompanisë së tij me Ronin, Veliun dhe si quhet ajo, zonja e autobllindit, famozja Puca.

© SYRI.net

Lexo edhe:



A do mbushet bregdeti i Semanit me parqe foto voltaike?
Sadushi i Fierit hap 5 tendera për dhënie me qira të 391 mijë m2 tokë



A do e lëshojë Rama, Ballukun? Berisha: Ka një tension real midis tyre pas arrestimit të Agasit



Berisha: Nuk kisha asgjë personale në përpjekjen time për një opozitë të pavarur. Kisha vetëm interes kombëtar

Muzeu hebraik në Vlorë/ Nezini: Godina i përket Klubit Labëria, po zhdukët historia



'Po blejnë influencë te zyrtarët e BE',
Xhaferri: Rama i mori 17 miliardë lekë Universitetit të Tiranës për Kolegjin e Evropës



SYRI TV/ Karakaçi: TEC-et do jenë pronë e KESH, ERE ka shtyrë licencimin e tyre



'Diaspora nuk ka për tia falur Ramës!
Shqiptarët e bashkuar pushteti i tmerruar!
Dita e 105 e protestës në foto

TË NGJASHME




Takimi me kryeprokurorin e SHBA/
Berisha: Paraqitëm problemet më kryesore të lidhura me shtetin ligjor dhe narkoshtetin



Berisha: Nuk kam qenë kurrë 'non grata'! Ata që u morën me këtë çështje kanë marrë ndëshkimin e merituar, nga McGonigal te Yuri Kim e Blinken



Berisha: Të gjitha problemet që denoncuam ne janë thënë edhe në seancën dëgjimore të Kongresit amerikan



Berisha: Diaspora na rezervoi një pritje të jashtëzakonshme. Ajo është gati të bëjë gjithçka për të ngritur përsëri në këmbë Shqipërinë



Berisha: Trump denoncoi rrezikun komunist dhe rrezikun e drogës, mbi të cilat qëndron regjimi i Ramës!
Mediat proqeveritare e censuruan fjalën e tij



Berisha: Në SHBA shprehëm shqetësimin për përdorimin e drejtësisë si armë politike nga Rama!
Shqipëria, parcelë eksperimentale e Sorosit



Berisha: Denoncuam farsën elektorale, sekretari Rubio nuk e uroi Ramën për zgjedhjet! Famëzinjtë Balluku, Rama, Agasi, Lindat...

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendojnë se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net